

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË INTEGRUAR MJEDISOR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Një nga funksionet kryesore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është krijimi dhe menaxhimi i sistemit të informacionit mjedisor, bazuar në pikën 1/d, të nenit 60, të ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar.

Në zbatim të kontratës publike "*Përmirësimi i Sistemit të Integruar Mjedisor - për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit*", do të implementohet sistemi elektronik i cili ka objektiv kryesor përmirësimin e sistemit të integruar mjedisor, duke dixhitalizuar të gjithë proceset e punës së institucionit që nga momenti i aplikimit, përpunimit të informacionit brenda institucionit dhe atyre të përfshira në këtë proces. Përveç databazave të reja të ngritura për detyrimet që Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kundrejt legjislacionit mjedisor, ky sistem do të ndërlidhet edhe me Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bazën e të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi *e-Leje*), bazën e të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të *e-inspektimi* në Inspektoriatin Qendror, të dhënat gjeohapësinore për koordinatat dhe shapefiles për çdo leje/licencë nga ndërveprimi me sistemin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Regjistrin Elektronik të Kimikateve në *e-albania* të Zyrës së Kimikateve si dhe çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me sistemin SIM dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Qëllimi kryesor i Sistemit të Integruar Mjedisor për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është të modernizojë dhe optimizojë menaxhimin e të dhënave mjedisore

dhe proceset operative brenda agjencisë. Aplikimet për leje mjedisore, monitorimin, raportimin dhe vlerësimet e ndikimit në mjedis, do të sigurojnë një platformë të aksesueshme për publikun për transparencë dhe informacion. Po ashtu ky sistem synon të rrisë efikasitetin, përmirësojë vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe të forcojë mbikëqyrjen mjedisore. Nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së avancuar dhe praktikave më të mira të sigurisë së të dhënave, projektvendimi ka për qëllim të mbështesë objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të ndërtojë një sistem që është në shërbim të nevojave të shoqërisë, të biznesit dhe të institucioneve qeveritare.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet do të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Objektivi kryesor i këtij projektvendimi është përmirësimi i sistemit të integruar mjedisor duke dixhitalizuar të gjithë proceset e punës së institucionit që nga momenti i aplikimit, përpunimit të informacionit brenda institucionit dhe atyre të përfshira në proces dhe deri te kthimi i përgjigjes aplikuesit. Digjitalizimi i proceseve do të sjellë dhe gjenerime të sakta raportesh.

Rezultatet që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projekt vendimi janë:

1. Ngritja dhe Mirëmbajtja e Sistemit të Integruar Mjedisor;
2. Raportimi në formë elektronike nëpërmjet sistemit e-Albania nga subjektet private dhe shtetërore;
3. Automatizimi i Procesit të Aplikimit dhe Menaxhimit të Lejeve Mjedisore;
4. Platformë e Qëndrueshme për Vetëmonitorimin dhe Raportimin;
5. Portali Publik për Transparencë dhe Qasje në Informacion
6. Moduli i Analizës dhe të Dhënave;
7. Integrimi dhe shkëmbimi i të dhënave me sisteme të tjera si:
 - a. Databaza e lejeve mjedisore të miratuara.
 - b. Databaza e lejeve mjedisore aktive.
 - c. Databaza e lejeve mjedisore të revokuara.
 - d. Databaza e licencave III.2.B.
 - e. Databaza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të Thelluar.
 - f. Databaza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Paraprake.
 - g. Databaza e raporteve të vetëmonitorimit.
 - h. Databaza e mbetjeve që gjenerohen në Republikën e Shqipërisë nga të gjitha llojet e rrymave si dhe nga operatorë privatë dhe publikë.

- i. Regjistri Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN).
- j. Regjistri i Kimikateve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij dokumenti nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2025, por të dhënat e grumbulluara në këtë bazë të dhënash do të përdoren për raportime kombëtare në hartimin e dokumentave politike dhe strategjike si dhe në raportime ndërkombëtare ku vendi ynë ka detyrime në konventat ose protokollet ku ne aderojmë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nga analiza e ushtrimit të funksioneve dhe realizimit të detyrave të AKM-së, është vënë re mungesa e një baze të dhënash të integruara që ndërlidh të gjitha drejtoritë qendrore dhe ato rajonale. Kryesisht të dhënat kryesore që duhet të përfshihen në këtë bazë të integruar të dhënash mund të klasifikohen në leje të mjedisit të tipit A dhe B, vlerësimet e ndikimit në mjedis (VNM), raportet e vetëmonitorimit që operatorët kanë si detyrim për raportim në kuadër të kushteve të lejes që ato zotërojnë si dhe të gjitha detyrimet që AKM ka në zbatim të legjislacionit të posacëm për të grumbulluar të dhëna nga institucione të ndryshme, si institucioni kryesor për prodhimin e statistikave mjedisore të cilat raportohen në INSTAT.

Krijimi i databazës do të garantojë raportime/informacione të sakta nga ana e subjekteve, renditjen e këtij raportimi/informacioni në një sistem të sigurt, si dhe do të garantojë identifikimin e kujt do që akseson këtë informacion dhe të çdo subjekti që nuk përmbush kërkesën për raportim brenda afateve të miratuara në dokumentin mjedisor që mban.

Projektvendimi trajton në detaje mënyrën e shkëmbimit të informacionit dhe të mbajtjes së të dhënave në nivel rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit.

Projektvendimi gjithashtu do të orientojë strukturat përgjegjëse të AKM, Agjencie Rajonale të Mjedisit, MTM dhe përdorues në nivele të tjera se si të përdorin sistemin, si të mbartin të dhënat dhe si të prodhojnë raportet nga sistemi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është dokument teknik i hartuar në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi vendas dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim të legjislacionit evropian.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese E PËRMBAJtjes SË DOKUMENTIT

Projektvendimi është i strukturuar në 10 (dhjetë) pika:

Në pikat 1-3, të projektvendimit, jepen të dhëna mbi emërtimin e bazës së të dhënave, institucioni administrues, klasifikimi /ndarja e të dhënave në parësore e dytësore ndërveprimi me sisteme /platforma të tjera elektronike.

Në pikat 4-8, shpjegohet se kush janë kontribues/dhënës të informacionit, subjektet e interesuara, se si ruhen apo përpunohen të dhënat, nivelet e aksesimit për përdoruesit,.

Në pikat 7-9, jepen shpjegime, mbrojtja e sistemit nga dëmtime, ndryshimet, etj.

Pika 10 jep institucionet që ngarkohen për zbatimin e aktit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacioni shoqërues i projektvendimit “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar mjedisor”

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe drejtoritë rajonale, AKEM, ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Inspektoriat i Përgjithshëm, Zyra e Kimikateve, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Dokumenti është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Projektvendimi do përcillet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i projektvendimit nuk ka kosto mbi buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për rrjedhojë as në buxhetin e shtetit, pasi efektet financiare janë ezauruar në ndërtimin e sistemit, i cili ka edhe përgjegjësinë për mirëmbajtjen për dy vitet e para.

Nga ana financiare ky dokument ofron lehtësi, pasi kërkuesit do të mund ta kërkojnë ofrimin e shërbimit nëpërmjet platformës *e-Albania*, pa kosto.

Implementimi i bazës së të dhënave sipas kontratës publike me titull "Përmirësimi i Sistemit të Integruar Mjedisor - për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit" sipas kontratës së shërbimit nr.119 prot., datë 24.12.2024 midis Autoritetit Kontraktor - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Operatorit ekonomik - "Fastech" me përfitues shërbimi Agjencia Kombëtare e Mjedisit, financuar nga Buxheti i Shtetit, rezulton me një vlerë totale prej 239,880,000 (dyqind e tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë me TVSH.

MINISTËR

Mirela KUMBARO FURXHI

